

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 1687 Rep.

Nr. 487 Kol.

KONTRATE SHITJE KUOTASH
Neni 23 i ligjit 7632 date 4.11.1992

Sot ne daten 10 Prill 1999 (nentedhjet e nente) u paraqiten personalisht para meje, notere Ruko SAKO, me adrese ne rrugen e Durrësit, palet kontraktuese si vijon :

SHITESI : Z. Alberto VIELMO, lindur me 25 nentor 1943, banues ne Cittadella (PD) rruga M.Ortigara Nr.2, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,i cili perfaqesohet me prokuren Nr. Rep.60511 date 22 Tetor 1996 nga Z. Matteo Scalco, i biri Leonzios, lindur me 15.08.1944 dhe banues ne Cittadella , rruga “Santa Luçia” Nr.17, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i shoqeruar nga perkthyesia Znj. Raimonda Gjençaj.

BLERESI : Shoqeria “A.G.D.” SHPK e perfaqesuar nga Z. Adrian Dulaku, i biri Nikos, lindur me 5 Shkurt 1960 dhe banues ne Tirane, ne Rrugen “Qemal Stafa” Pall.188, Ap.3, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pasaporten Nr. AZ 096088.

Te dy palet me kerkuan redaktimin e shitblerjes kuotave qe vijon :

Ne baze te vendimit te Gjykates Rrethit Tiranes Nr. 5319 date 6.07.1994 eshte njohur person juridik Shoqeria “ Edil Al It” SHPK me seli ne Tirane me ortaket : Shoqeria “A.G.D.” Sh.P.K. me 30% te kuotave, Shoqeria “ZANON COSTRUZIONI” S.P.A.(me vone e emertuar “SILAC costruzioni” s.p.a., qe ka 47% te kuotave, Z. Leonardo Antonio, qe ka 3% te kuotave , Z. Franco Frigo, i cili ka 10% te kuotave dhe Z.Alberto Vielmo qe ka 10% te kuotave.

Z. Matteo Scalco deklaroi se 10 % te kuotave te Z.Alberto Vielmo ne shoqerine “Edil Al It” Sh.P.K. ja shet shoqerise “ A.G.D., per te cilen deklaroi se i blen perfaqesuesi i saj Z. Adrian Dulaku. Per blerjen e tyre bleresi i likujdoi shitesit shumen prej 10.000 (dhjete mije) leke, shume e cila u likujdua jashte zyres noterise.


Me nenshkrimin e kesaj kontrate noteriale dhe me regjistrimin e saj ne Gjykatën e Rrethit Tiranes, shitesi e humbet çdo te drejte pronesie ne shoqerine “Edil Al It” SHPK dhe pronare i vetem i kuotave te tij behet Shoqeria A.G.D. SHPK. Duke ju shtuar ketyre kuotave edhe 30% te ajo vete ka ne kete shoqeri, Shoqeria “A.G.D.” Sh.P.K. behet pronare e 40% te kuotave te Shoqerise “Edil Al It” SHPK.

Kopjes se kontrates qe do te qendroje ne Zyren e Noteris ne Tirane i bashkangjiten vendimi i Gjykates Rrethit Tiranes.

Sa me siper perpilohet nga une noterja kjo kontrate shitblerje kuotash,
e cila ju lexohet paleve me ze , ne prezencen e perkthyeses Znj. Raimonda
Gjençaj,dhe mbasi gjendet konforme vullnetit te tyre te lire e te plote, e firmosin
rregullisht ate, ndersa une e vertetoj ate sipas ligjit.


SHITESI

Z. Alberto VIELMO,
perfaqesuar nga Z.
Matteo SCALCO



BLERESI

Shoqeria "A.G.D." SHPK
e perfaq. nga Z. Adrian DULAKU

Adrian Dulaku


BUKURSI
SHOMA E NOTERIT
E TIRANE

